

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 279, datë 14.7.2021

PËR RREGULLAT DHE MËNYRAT E ZBATIMIT TË SANKSIONEVE
ADMINISTRATIVE PËR MJETET LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË
ARGËTIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 127/2020, “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

UDHËZOJNË:

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton procedurat, rregullat dhe mënyrën e zbatimit të sanksioneve administrative në rastet kur konstatohen shkelje me mjetet lundruese turistike dhe të argëtimit.

2. Ky udhëzim zbatohet për lëvizjen e të gjitha mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit në hapësirën detare shqiptare dhe ujërat e brendshme tokësore.

3. Ky udhëzim nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, të kapitenarisë së porteve, të forcave të policisë, të doganave dhe të organeve të tjera të parashikuara me ligj.

KREU II
KONTROLLI I AKTIVITETIT TË MJETEVE LUNDRUESE

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit kur konstaton mjete lundruese, objekt të ligjit nr. 127/2020, “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”, (në vijim ligji), që lëvizin në dete, liqene, rezervuarë dhe lumenj ose kur transportohen në rrugë automobilistike, ushtron kontroll të dokumentacionit vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) ka indicie/informacion të arsyeshëm mbi subjektin;
- b) konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit ujqor.

2. Nëse mjetet lundruese nuk janë të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detare (ZRMLD), sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 5 të ligjit, punonjësit e policisë bëjnë bllokimin e mjetit lundrues dhe informojnë shërbimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit, përgjegjëse për territorin. Policia Kufitare dhe Migracionit, pas verifikimit të shkeljes së konstatuar, në bashkëpunim me zyrat vendore të kapitenarisë, kryejnë procedurat e mëtejshme për marrjen e masave administrative.

3. Subjekti që importon një mjet lundrues depoziton pranë ZMRLD-së një kopje të deklaratës së importit të konfirmuar nga autoritetet e Policisë Kufitare, e cila me kërkesën e pronarit ose bashkëpronarit bën regjistrimin e mjetit lundrues.

4. Në rast se gjatë inspektimeve Drejtoria e Përgjithshme Detare konstaton mjete lundruese që nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara në ligj, njofton shërbimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit për marrjen e masave administrative.

5. Në rastet kur gjatë kontrollit të mjetit lundrues konstatohet se drejtuesit, pronarët apo bashkëpronarët e mjetit lundrues janë në shkelje të detyrimeve të parashikuara në nenin 13, të ligjit, përveç masave administrative për shkeljen e konstatuar, mjeti lundrues shoqërohet në stacionin e Policisë Kufitare, përgjegjëse për territorin, si dhe materialet përkatëse i përcillen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.

KREU III

PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE VEPRIMIT PËR KUNDËRVAJTJET

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, për shkeljet e konstatuara nga drejtuesit e mjeteve lundruese, vepron sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në nenin 14 të ligjit.

2. Punonjësi i policisë përpilon procesverbalin e konstatimit të shkeljes, sipas modelit nr. 1 bashkëlidhur, procesverbal i cili mbahet në dy kopje, një kopje për kundërvajtësin dhe një kopje dorëzohet në stacionin e Policisë Kufitare.

3. Shefi i stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, referuar shkeljes së konstatuar, në bazë të procesverbalit model nr. 1, merr vendim për:

3.1 Masën e dënimit me gjobë të kundërvajtësit;

3.2 Kohëzgjatjen e bllokimit administrativ apo zhbllokimit të mjetit lundrues;

3.3 Heqjen e dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues, sipas shkronjës “j”, të nenit 14, të ligjit nr. 127/2020;

3.4 Mbyllje të subjekteve të certifikuara për ndërtimin, riparimin, rikonstruktimin e mjeteve lundruese.

4. Në zbatim të nenit 14 të ligjit, punonjësi i policisë mban dhe plotëson procesverbalin tip, sipas lidhjeve pjesë përbërëse e këtij udhëzimi për:

4.1 Konstatimin e shkeljes administrative nga kundërvajtësi apo nga subjektet, sipas pikës 3.4 të këtij udhëzimi;

4.2 Dorëzimin e mjetit lundrues në pikën e bllokimit;

4.3 Rikthimin e mjetit lundrues.

5. Në rastet e dënimit me gjobë një kopje e vendimit, sipas modelit nr. 2, i dorëzohet kundërvajtësit kundrejt firmës dhe pretendimeve të tij, një kopje i dorëzohet Sektorit të Financës në komisariat/in/drejtorinë e kufirit dhe migracionit dhe kopja e tretë qëndron në fletën e bllokut të gjobave në stacionin e Policisë Kufitare.

5.1 Pagesa e gjobës bëhet brenda 5 (pesë) ditëve dhe për çdo ditë vonese, deri në një muaj, aplikohet kamatëvonese në masën 2% të gjobës.

5.2 Administrimi i vendimit për vendosjen e gjobës dhe kryerja e veprimeve të kontabilitetit në regjistrat përkatës kryhen sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

6. Për shpenzimet e ndërhyrjes, të transportit, të parkimit dhe të zhbllokimit të mjetit lundrues, të kryera nga policia, aplikohen tarifat e përcaktuara sipas pikave 4 dhe 5, të urdhrin nr. 35, datë 5.2.2016, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Policia e Shtetit”, të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

7. Punonjësi i policisë, për rastet kur dispozita e shkelur parashikon masën e bllokimit administrativ të mjetit lundrues ose të mjeteve të tjera që kanë shërbyer për transportin e tyre, bën shoqërimin e mjetit lundrues në pikën e bllokimit të tyre dhe përpilon procesverbalin e dorëzimit të mjetit lundrues, sipas modelit nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7.1 Procesverballi, sipas pikës 7 të udhëzimit, përpilohet në 3 (tri) kopje, një kopje i dorëzohet kundërvajtësit, një kopje qëndron në pikën e bllokimit dhe kopja e tretë dorëzohet brenda ditës në stacionin e Policisë Kufitare.

7.2 Mjeti i bllokuar, me vendim sipas modelit nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi, lihet në ruajtje në pikën e bllokimit të mjeteve lundruese, kundrejt konfirmimit të marrjes në dorëzim nga punonjësi i policisë, deri në përfundim të procedurave të marrjes së vendimit përfundimtar. Kur vendimi përfundimtar është dënimi me gjobë, mjeti mbahet i bllokuar deri në likuidimin e vlerës së gjobës.

7.3 Për evidentimin e mjeteve lundruese të bllokuara, në pikën e bllokimit krijohet një regjistër i veçantë i sekretuar.

8. Mjetet lundruese të bllokuara zhblokohen me marrjen e vendimit, sipas modelit nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga shefi i stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, pas verifikimit për përmbushjen e detyrimeve, si më poshtë:

a) plotësimin e afatit dhe përmbushjen e detyrimeve duke bërë shënimet në regjistrin përkatës;

b) likuidimin e detyrimeve financiare si:

i. vlera e gjobës së përcaktuar në procesverbalin përkatës;

ii. shpenzimet e ndërhyrjes;

iii. shpenzimet e transportit (vetëm në rastet kur veprimi është kryer me mjetet e policisë);

iv. shpenzimet e parkimit.

8.1 Në pikën e bllokimit të mjeteve lundruese punonjësi i policisë përpilon në dy kopje procesverbalin për rikthimin e mjetit, sipas modelit nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga të cilat një kopje i jepet subjektit, ndërsa kopja tjetër i bashkëlidhet dokumenteve të mjetit lundrues, të cilat janë pjesë e arkivit të stacionit të Policisë Kufitare.

9. Në raste të veçanta, me urdhër të drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, mjeti lundrues lihet në ruajtje në venddislokimin e mjeteve lundruese të Policisë Kufitare.

10. Zyra e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe detare, në rast të konstatimit të shkeljes së afateve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 8 dhe në pikën 3, të nenit 9, njofton Policinë Kufitare për vijimin e procedurave të vënies së sanksionit administrativ të përcaktuar në nenin 14, të ligjit. ZRMLD-ja bën regjistrimin e mjetit lundrues, pas depozitimit të dokumentit vërtetues të shlyerjes së masës administrative me gjobë të vendosur nga oficeri i Policisë Kufitare.

11. Kur konstatohen shkelje në fabrikat, kantieret detare, ofiçinat e prodhimit dhe riparimit të mjeteve lundruese, referuar gurmës “ë”, të pikës 1 dhe 3, të nenit 14 të ligjit, shefi i stacionit të Policisë Kufitare merr vendim bazuar në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, sipas modelit nr. 7 dhe 8, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. Në rastet e dënimit me gjobë një kopje e vendimit për vendosjen e gjobës i dorëzohet kundërvajtësit kundrejt firmës dhe pretendimeve të tij, një kopje i dorëzohet Sektorit të Financës në komisaratin/drejtorinë e kufirit dhe migracionit dhe kopja e tretë qëndron në fletën e bllokut të gjobave në stacionin e Policisë Kufitare.

13. Në zbatim të pikës 3, të nenit 14 të ligjit, dënimi me gjobë mund të shoqërohet me masën plotësuese të mbylljes së fabrikës/kantierit detar/ofiçinës nga 30 (tridhjetë) deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

14. Kryerja nga mjeti lundrues i një veprimtarie të kundërligjshme, sipas rasteve të përcaktuara në shkronjën “h”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit, shefi i stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit merr vendim, sipas modelit nr. 9, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

1. Për vendosjen e masave administrative, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në drejtorinë vendore për kufirin dhe migracionin, brenda 30 ditëve nga dita e nesërme e marrjes në dijeni të vendosjes së masës administrative.

2. Ndaj vendimit të marrë nga drejtoria vendore për kufirin dhe migracionin kundërvajtësi mund të bëjë ankim në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e marrjes në dijeni të tij.

3. Ndaj vendosjes së masës administrative të konfiskimit, sipas shkronjës “h”, të pikës 1, të nenit 14 të ligjit, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e marrjes në dijeni.

4. Ndaj vendimeve të marra kundërvajtësi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Dokumentet e përpiluara për masa administrative, për shkeljet që bëhen me mjetet lundruese, ruhen 1 (një) vit pas përfundimit të ekzekutimit të vendimit.

2. Mjetet lundruese objekt i këtij udhëzimi, kur kalojnë në favor të shtetit dorëzohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi Drejtoria e Përgjithshme Detare njoftohet për mjetet që sekuestrohen.

3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 314, datë 29.5.2018, “Për mënyrën e regjistrimit, përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit drejtoritë vendore të kufirit dhe migracionit dhe drejtoritë vendore të policisë dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Model nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000

Nr. regj. _____

_____, më _____. 2021.

PROCESVERBAL

I KONSTATIMIT TË SHKELJES

(Punonjësi PSH)

Data __, muaji __, viti __, ora __, Sektori __, vendi __. Unë i nënshkruari _____ konstatova se kundërvajtësi:

_____, adresa: _____

(emër, mbiemër)

Lloji i mjetit _____, tipi _____, emri _____ nr. matrikullit: _____, sasia e motorëve _____.

Me pronar të mjetit _____, adresa _____, ose fabrika/kantieri detar/ofiçina pronë e shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____,

(emër, mbiemër)

ka shkelur ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, neni _____

Kundërvajtësi deklaron: _____

Për shkeljet e konstatuara propozoj:

Sanksioni: Të gjobitet me _____ (_____) lekë.

Sanksione plotësuese:

Blokim administrativ

Kundërvajtësi të paraqitet _____ ora _____, data _____. _____. _____.

Kundërvajtësi

(_____)

(emër, mbiemër, firma)

Përpiluesi i procesverbalit

(_____)

(grada, emër, mbiemër, firma)

Model nr. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000

_____, më _____.2021.

Nr. regj. _____

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE GJOBË

Në _____, viti _____, muaji _____, data ____, ora _____,
unë i nënshkruari _____ Shefi i Stacionit/Komisariatit të Policisë
(grada, emër, mbiemër)

Vendore të KM _____; pasi u njoha me procesverbalin e konstatimit të shkeljes nr. _____, datë
____.____.____.

Kundërvajtësi deklaron: _____

VENDOSA:

Për shkeljet e konstatuara:

Sanksioni: Të gjobitet me _____ (_____) lekë.

Sanksione plotësuese:

1. Heqjen e dëshmisë së aftësisë për drejtimin e mjetit lundrues për 60 ditë;
2. Shpenzime ndërhyrjeje _____ (_____) lekë;
3. Shpenzime transporti _____ (_____) lekë;
4. Shpenzime për ruajtje për ditë qëndrimi (_____) lekë;
5. Shpenzime për bllokimin _____ (_____) lekë;
6. Shuma e detyrimit _____ (_____) lekë;

Kundërvajtësi të paraqitet _____ ora _____, data _____. _____. _____.

Kundërvajtësi

(_____)
(emër, mbiemër, firma)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të PKM-së

(_____)
(grada, emër, mbiemër, firma)

**DREJTORIA E PËRGJITHSH
DEPARTAMENTI PËR KUI
DREJTORIA VENDORE PËR I**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 000000000

Nr. regj. _____

_____, më __. __. 2021.

VENDIM

PËR BLOKIMIN ADMINISTRATIV TË MJETIT LUNDRUES

Në _____, viti _____, muaji _____, data __, ora _____,
unë i nënshkruari _____ oficer i Policisë Kufitare pranë Drejtorisë
(grade, emër, mbiemër)

Vendore të KM-së _____; pasi u njoha me procesverbalin e konstatimit të shkeljes nr. _____,
datë __. __. _____,

VENDOSA:

Të bëjë bllokimin administrativ të mjetit lundrues tip _____, lloji _____, emri
_____, nr. matrikulli: _____, sasia e motorëve _____, me nr. _____
dhe _____, gjatësia _____, pronë e shtetësit _____, i biri i
_____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në
_____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____.

Mjeti bllokohet administrativisht për _____ ditë, për arsye se drejtuesi i tij _____ i vitlindjes
_____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____
ka shkelur me këtë mjet ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, neni 14, geramat: "b"; "c"; "ç"; dhe "d", _____.

Së bashku me mjetin lundrues të lartpërmendurit i bllokohen dhe sendet e poshtëshënuara:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____

Procesverbali mbyllet me numër rendor _____.

Pronari (drejtuesi i mjetit)

(_____)

(emër, mbiemër, firma)

Shefi i Stacionit të PKM-së

(_____)

(grada, emër, mbiemër, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000

Nr. regj. _____

_____, më _____.2021.

PROCESVERBAL

PËR DORËZIMIN E MJETIT LUNDRUES NË PIKËN E BLOKIMIT

I mbajtur sot më datë _____, pranë pikës së bllokimit _____, për dorëzimin e mjetit lundrues tip _____, lloji _____, emri _____, nr. matrikulli: _____, sasia e motorëve _____, numrat e motorëve: 1) _____ dhe 2) _____ gjatësia _____, ngjyra _____, në pronësi të _____, në përdorim të _____.

Mjeti lundrues dorëzohet sipas inventarit të mëposhtëm:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

Marrësi në dorëzim

(grada, emër, mbiemër, firma)

Dorëzuesi

(grada, emër, mbiemër, firma)

Pronari i mjetit lundrues

(emër, mbiemër, firma)

Model nr. 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. regj. _____

_____, më __.__.2021.

VENDIM

PËR ZHBLLOKIMIN E MJETEVE LUNDRUESE

Mjeti lundrues tip _____, lloji _____, emër _____,
nr. matrikulli: _____, të zhbllokohet pasi plotësoi afatin dhe likuidoi detyrimet
financiare.

Shefi i Stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit _____
(grada, emër, mbiemër, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. regj. _____

_____, më _____.2021.

PROCESVERBAL

PËR RIKTHIMIN E MJETIT LUNDRUES

Procesverbal i mbajtur sot më datë _____.____.____, në pikën e bllokimit të mjeteve lundruese _____, për zhbllokimin e mjetit lundrues të tipit _____, lloji _____, emri _____, nr. matrikullit: _____, me _____ motor/ë, me nr. motori _____ dhe _____, në pronësi të _____.

Mjeti lundrues i dorëzohet pronarit sipas inventarit të mëposhtëm:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

Mbyllet me nr. rendor ____ (_____).

DORËZUESI

MARRËSI NË DORËZIM

(grada, emër, mbiemër, firma)

(emër, mbiemër, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000

Nr. regj. _____

_____, më _____.2021.

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE GJOBË PRONARIT TË FABRIKËS OSE KANTIERIT DETAR

Në _____, viti _____, muaji _____, data _____.

Unë _____
(grada, emër, mbiemër)

_____, në përputhje me nenin 188, të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, pasi bëra verifikimin e ngjarjes dhe të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, plotësuar nga punonjësi i policisë

_____.

VENDOSA:

Masën administrative ndaj pronarit të fabrikës (oficinës, kantierit) _____, shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes

_____, banues në _____,

Me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____.

Pronari i fabrikës/kantierit detar/oficinës, në shkelje të nenit 10, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, si dhe bazuar në nenin 14, germa “ë”, të tij, gjobitet me

_____.

Pronari i fabrikës

(_____)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të PKM-së

(_____)

(grada, emër, mbiemër, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000

Nr. regj. _____

_____, më _____.2021

VENDIM

**PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE MBYLLJE TË AKTIVITETIT TË
FABRIKËS/KANTIERIT DETAR/OFIÇINËS**

Në _____, viti _____, muaji _____, data _____, unë _____
(grade, emër, mbiemër)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit.

_____, në përputhje me nenin 188, të K. Pr. Penale dhe ligjin nr. 127, datë 15.10.2020, pasi bëra verifikimin e ngjarjes dhe të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, plotësuar nga punonjësi i policisë

_____.

VENDOSA:

Mbylljen e aktivitetit të fabrikës (oficinës, kantierit detar) _____, pronë e shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____.

Fabrika (kantieri detar, oficina) të mbyllë aktivitetin për _____ ditë, në raste të përsëritjes së shkeljes nga pronari i saj, të nenit 10, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, si dhe bazuar në pikën 3, të nenit 14, të këtij ligji.

Kundër kësaj mase administrative pronari i objektit të bllokuar ka të drejtë ankimi sipas akteve ligjore.

Pronari i fabrikës

(_____)

Shefi i Stacionit/Komisariatit në PKM

(_____)

(grada, emër, mbiemër, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

Nr. 000000000

Nr. regj. _____, më _____.2021.

VENDIM

PËR VENDOSJEN E MASËS ADMINISTRATIVE KONFISKIM TË MJETIT LUNDRUES

Në _____, viti _____, muaji _____, data _____,

Unë _____ punonjësi i policisë pranë Drejtorisë Vendore të KM _____,
(grada, emër, mbiemër)

në përputhje me nenin 14, pika 1, germa “h”, të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, pasi bëra verifikimin e ngjarjes dhe të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, plotësuar nga punonjësi i policisë _____,

VENDOSA:

Masën administrative të konfiskimit ndaj mjetit lundrues me pronarë/bashkëpronarë, drejtues mjeti lundrues _____, shtetasit _____, i biri i _____ dhe i _____, i vitlindjes _____, banues në _____, me shtetësi _____, gjendje gjyqësore _____, të mjetit _____ me nr. matrikulli _____, me ___ motor/ë me KF _____, me nr. serie _____.

Pronari/bashkëpronari, drejtues i mjetit lundrues, _____ me nr. regjistrimi detar/oficinës, në shkelje të nenit 14, pika 1, germa “h”, të ligjit nr. 127, datë 15.10.2020, të bëhet konfiskimi i mjetit lundrues.

Kundër këtij vendimi shtetasi ka të drejtë të ndjekë rrugët e ankimit në organet e drejtësisë.

Pronari/b/pronari, drejtues i mjetit lundrues
(_____)

Shefi i Stacionit/Komisariatit të PKM-së
(_____
(grada, emër, mbiemër)